


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	07/11/2013
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Bajram KOLGECI Zyrtar i Prokurimit në Universitetin e Prizrenit "Ukshin HOTI"
CC:	z. Adem SALLAUKA Sekretar i përgjithshëm në Universitetin e Prizrenit "Ukshin HOTI"
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin: "Renovimi i Fakultetit të Edukimit"

Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Renovimi i Fakultetit të Edukimit" me nr: prokurimi: 10208-013-051-511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Renovimi i Fakultetit të Edukimit", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Universiteti i Prizrenit “Ukshin HOTI” më datë 23/10/2012 përmes KRPP-së ka shpallur “Njoftim për Kontratë” për tenderin “Renovimi i Fakultetit të Edukimit”, me numër Prokurimi: 10208-013-051-511. Divizioni i Parandalimit të Korrupsionit në Prokurim Publik, pran Departamentit të Parandalimit në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të kësaj procedure të prokurimit, në “Njoftim për Kontratë” Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me procedurat e prokurimit sipas ligjeve në fuqi.

Universiteti i Prizrenit “Ukshin HOTI” si Autoriteti Kontraktues këtë procedurë prokurimi nuk e ka paraparë në Planifikimin e Prokurimit të vitit 2013. Legjislacioni në fuqi, mundëson që prokurimet që nuk janë paraparë për vitin përkatës fiskal, mund të prokurohen nëse për të njëjtin prokurim Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) do të dërgojë tek Agjencia Qendrore Prokurimit (AQP) një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues në “Dosja e Tenderit”, në pikën III.2 Kushtet për Pjesëmarrje, tek nënpika III.2.2 Përshtatshmëria Profesionale nuk ka kërkuar Certifikatë, ndërsa tek Dëshmia e kërkuar Dokumentare në pikë g. ka kërkuar Certifikatën ISO 9001:2008

Në pikën III.2.3 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar është kërkuar:

- Qarkullimi financiar për tri vitet e fundit (2010, 2011 dhe 2012) të jetë min.3.000.000.00 €.
- Në rast Konzorciumi Lideri duhet të ketë jo me pak se 70% të qarkullimit.
- Në rast Konzorciumi secili nga anëtarët e Konzorciumit duhet ta kenë raportin e Auditimit për (2010,2011 dhe 2012) nga auditorët e certifikuar

Gjithashtu në Kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale në mes tjerash kërkohej:

- Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale e personelit, që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ekzekutimin e projektit të punëve ose për realizimin e aktiviteteve të ndërtimit me minimum 50 punëtor të deklaruar dhe të vërtetuar nga ATK për tri vitet e fundit duke përfshirë edhe stafin profesional .
- Lista e punëve të kryera në lëmin e ndërtimit dhe renovimit minimum 3 milion € në tri vitet e fundit 2010,2011,2012 të dëshmuara me kontrata, referenca dhe pranime teknike për kryerjen e punëve.

Kriteret lartë cekura në pikën III.2.3 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar si dhe tek Kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në “Dosja e Tenderit” janë kritere

diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë dhe favorizojnë Operatorët Ekonomik të caktuar.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; Nenin 8 Planifikimi i Prokurimit; Nenin 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur; Nenin 27 Dosja e Tenderit; Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes; Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042.

Shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedurat e prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra

Me respekt!